



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.3384/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit K... nga Prishtina, e përfaqësuar nga drejtori i saj B.H – përfaqësues ligjor, e të cilin e përfaqësojnë të autorizuarit e tij av.A.K dhe av.N.H.V që të dy nga Prishtina, kundër të paditurit Y...me seli në Prishtinë, me përfaqësuesen e autorizuar – drejtoreshen M.SH, e të cilën e përfaqëson e autorizuar e saj av.M.S.E nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2756/10, të datës 26.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e paditësit K... nga Prishtina, e përfaqësuar nga drejtori i saj B.H – përfaqësues ligjor, si dhe ankesa e të paditurës Y...me seli në Prishtinë, me përfaqësuesen e autorizuar – drejtoreshen M.SH, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2756/10, i datës 26.04.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar padinë dhe kërkespadinë e paditësit K... e përfaqësuar nga drejtori i saj B.H – përfaqësues ligjor, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Y...me seli në Prishtinë, me përfaqësuesen e autorizuar – drejtoreshen M.SH, në kompensimin e dëmit material në emër të shpifjes, për shkak të mos lidhjes së kontratave të marketingut në shumën prej 235.000,00, si dhe në emër të dëmit material për shkak të rrënimit të reputacionit, në shumën prej 50.000,00 euro, si dhe të obligohet i padituri që të publikoj aktgjykimin në gazeta ditore dhe në TV nacionale, të gjitha në afatin prej 15 ditëve prej marrjes së aktgjykimit. Me pikën II të aktgjykimit është obliguar paditësi që t'i mbuloj shpenzimet e procedurës kontestimore të paditurës në shumën prej 1.019,20 euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësi përmes të autorizuarve të tij, ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ose që të njëjtin ta prish dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, edhe i padituri përmes të autorizuarve të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë vetëm në raport me pikën II të aktgjykimin e cila ka të bëjë me shpenzimet e aprovuara të procedurës, duke e atakuar të njëjtin për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale në raport me shpenzimet e procedurës kontestimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e saj si të bazuar, kurse aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe ta aprovoj ashtu që të njihen shpenzimet e procedurës në lartësinë sikurse në propozim të ankesës.

Palët ndërgjyqëse përmes të autorizuarve të tyre kanë parashtruar edhe përgjigje në ankesat e njëri tjetrit, me propozime sikurse në këto përgjigje në ankesa.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësit, është **e pabazuar**;
- ankesa e të paditurit, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 24.06.2010, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensim dëmi si pasojë e shpifjes, me arsye sikurse në padi.

Duke vendosur sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë pasi që ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.2756/10, të datës 26.04.2018, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të aktgjykimin në fjalë. Në arsyetim të tij është theksuar se në rastin konkret nuk ka qenë kontestues asnjëra prej provave të administruara, por kontestuese është paraqitur të jetë fakti i ekzistimit apo i mos ekzistimit të shpifjes dhe fyerjes, ku paditësi ka pretenduar se si pasojë e shpifjes dhe fyerjes ka pësuar dëm në kuptim të mos nënshkrimit të disa kontratave të marketingut, si dhe dëm material në kuptim të dëmtimit të reputacionit, kurse e paditura e ka konstestuar ekzistimin e veprës së shpifjes dhe fyerjes me arsyetimin se publikimi i saj ka qenë i arsyeshëm në të gjitha rrethanat e kontekstit për paditësin, për pozitën që e mbante, me që qëllimi ishte i mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështjen e interesit publik. Në vijim gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se pretendimi i paditësit për dëmin e pësuar ka qenë i paargumentuar dhe ka ra ndesh me vetë deklaratimet e paditësit, pasi që ky i fundit vetë ka theksuar se ka pësuar rritje si medium, në ndërkohë që nuk i ka parashtruar gjykatës në fjalë prova konkrete se cilat kontrata nuk janë nënshkruar nga paditësi si pasojë e veprimeve të të paditurit. Në vijim gjykata në fjalë ka theksuar se e ka refuzuar propozimin e

paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë përkatëse me qëllim të korigjimit të dëmit të shkaktuar ndaj reputacionit, pasi që paditësja ka pasur mundësi që një propozim të tillë ta bëjë në seancën përgatitore, me qëllim të vërtetimit të çfardo humbje të provueshme aktuale finaciare apo të dëmit material, e që nuk e ka bërë, pasi që deri në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, paditësja nuk ka ofruar dëshmitë për kontrata të cilat nuk janë realizuar, në mënyrë që pastaj gjykata e shkallës së parë të vendos konform nenit 14.1 të Ligjit për Shpifje (LSh). Tutje gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në pajtim me nenin 154 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD), e kërkesa e paditësit nuk ka pasur bazë juridike, në mënyrë që pastaj e paditura eventualisht të detyrohet në kompensimin e dëmit të pretenduar, pasi që nuk është provuar bazueshmëria e shpifjes dhe fyerjes, e as e shkaktimit të dëmit material të pretenduar, apo dëmit në kuptim të cenimit të reputacionit, të cilat eventualisht do të mundësonin kompensim efektiv dhe të përshtatshëm për në këtë rast paditësin, pasi që vet drejtori i paditësit ka deklaruar se K... është në rritje. Gjukata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka theksuar se në rastin konkret ka marrë për bazë obligimin që ka për të vendosur një baraspeshë (balancë) ndërmjet mbrotjes që duhet t'i ofroj lirisë së shprehjes dhe mbrotjes që duhet t'ua siguroj për mbrotjtjen e reputacionit të personave fizik dhe juridik, duke konstatuar se në rastin konkret nuk ka pasur kurrfarë rrënimi të reputacionit të paditësit K..., e as të përfaqësuesit juridik të saj - drejtorit B.H, nga vepra e shpifjes apo dhe e fyerjes, duke qenë se vetë ky i fundit ka deklaruar përgjatë procedurës se K..., vazhdimisht ka pas rritje dhe ka tendenca të mëtutjeshme të kësaj rritje, për çka baza e rrënimit të reputacionit në kuptimin e formës apo dhe drejtimit të ndodhur, nuk ka arritur të provohet në këtë procedurë. Me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nenin 10.1 dhe 10.2 të saj, që ka të bëjë me lirinë e shprehjes, si dhe nenet 6, 7, 8 dhe 10 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, e në lidhje me nenin 154 të LMD. Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK.

Gjukata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK.

Gjukata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në rastin konkret, e në bazë të provave të administruara nga ana e

gjykatës së shkallës së parë, paditësi me asnjë provë konkrete valide nuk ka arritur ta provoj të drejtën e tij të pretenduar me kërkesëpadi. Andaj pretendimet e tij mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e pasditësit në rastin konkret është e pabazuar.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452.1 të LPK. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjeti se edhe ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Gjykata e Apelit i analizoi dhe mori për bazë edhe pretendimet e tjera ankimore të palëve ankuese por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3384/18, me datën 26.02.2021

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj